



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE DIASPORËS

Nr. 14426 Prot

Vlorë, më: 18.09 2024

PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK
NJËSIA ADMINISTRATIVE NOVOSELË

Datë 11.09.2024 ora: 16:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2025 për Bashkinë Vlorë

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Per të drejtën e informimit” , ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.13107 datë 21.08.2024.

Marrin pjesë:

Kryetari i Bashkisë Vlorë-z. Ermal Dredha, Kryetari i Nj.A. Novoselë, Deputeti, z. Anduel Tahiraj; Administratori i Njësisë Administrative , z. Kanan Shakaj; Anëtarë të Këshillit Bashkiak; Kryetarë fshatrash dhe banorë të njësisë administrative; Përfaqësues nga administrata e bashkisë dhe nga institucionet në vartësi të bashkisë.

(Në takim morrën pjesë më shumë se 35 persona, listëprezenca bashkangjitur)

Takimin e hapi Kryetari i Bashkisë Vlorë, z.Ermal Dredha: Përshendetje, të gjithëve!

Dje ishim për të përkujtuar Dëshmorët e Myzeqesë, ndërsa sot jemi për një qëllim tjetër, për PBA 2025 – 2027 dhe Buxhetin e Bashkisë për vitin 2025.

Sigurisht që është punuar, por dhe nuk mund të bëhen të gjitha brenda një viti.

Bashkia Vlorë, ka patur ngarkesë gjatë kësaj kohe edhe për shkak të sezonit turistik, por duhet një punë dhe bashkëpunim me administratën dhe banorët.

Falënderoj zotin Kanan për punën e bërë, në lidhje me çdo problematikë këtu në njësinë tuaj. Duhet të kemi rezultate konkrete.

I pranishëm është dhe deputeti, zoti Tahiraj, për të dëgjuar më nga afër problematikën tuaj.

Idea është se, një nga problematikat, në njësi, është furnizimi i ujit të pijshëm. Janë 8 milion lekë për Ujësjetësin e Ri. Ka pasur probleme, kishte mospërputhje në vendosjen e tubave, për furnizimin me ujë të gjithë fshatrave. Kemi kontaktuar dhe me AKUMI-n. Projektet janë gati.

Z.Sokol Kananj/D.Nd.Sh.A.UjësjetësinëKanalizime – Jemi në fazën e mbylljes së projektit me disa fshatra. Kanë nevojë disa fshatra ...Pra, rrjeti shpërndarës si u bë në Novoselë do të bëhet dhe përfshijë 10 fshatra, përfshirë këtu dhe depozitat e ujit. Projektet janë në fazën përfundimtare, në nënstacione ka pasur probleme.

Banor – Shumë problem, Novosela pa ujë.

Z.Sokol Kananaj – Së fundmi filloi dhe linja me Aeroportin, po implementojmë projekt të ri, të madh.

Z.Kanan Shakaj – Janë 10 fshatra që përfitojnë me projektin e ri. Fshati Fitore, e ka bërë lidhjen e brendshme të tubacioneve.

Z.Ermal Dredha – Të bëjmë si fillim ato më të voglat. Të kemi mundësi, që ato që kemi propozuar, ti bëjmë sa të mundim. Përsa u përket projekteve të zonës, investimeve të parashikuara;

-Rikonstruksioni i rrugës së varrezave në fshatin Cerkovinë, rreth 61 milion lekë/vjetra

-Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Skrofotinë, me vlerë 73 milion lekë/vjetra. Kanë përfunduar si projekte.

-Kemi rrugët e brendshme në fshatin Mifol, fshatin Fitore, Aliban dhe për këto jemi në proces tenderimi. Vlera në fshatin Mifol rreth 3.5 milion lekë dhe për varrezat e fshatit Mifol, 82 milion lekë/vjetra.

Pra, idea është që këto tre rrugë janë me fondet e FSHZH. Vetëm dje u miratua buxheti i FSHZH. Derisa të tenderohen dhe të shpërndahen sipas kërkesave tona.

Drejtoria e Shërbimeve ka filluar një procedurë, për pajisjen me "Policët e shtirë" nëpër rrugë. E kemi kërkesë këtë nga zoti Kanan. Kjo është pak a shumë, si planifikime.

Kryetari i fshatit Trevllazër – Dëgjova shumë probleme, por ne nuk u diskutuam. Kemi 6 muaj pa ujë. Unë dua të zgjidhet problemi. Na duhet një tubo për emergjencë, janë 100 shtëpi pa ujë

-Problem një segment rruge.

-Dy varrezat kryesore të fshatit, nuk dëgjova asgjë për ato. Nuk është bërë gjë për fshatin tonë. Jemi pa ujë, rrugën e fshatit dhe rrugën e dy varrezave.

Z.Ermal Dredha – Jemi këtu për çfarë po bëjmë për vitin 2024.

Z.Kastriot Çobo – Përveç projektit të fshatit Mifol, kemi një lagje problem, rruga e brendshme.

Z.Ermal Dredha – Shumë mirë që i thoni ankesat tuaja, prandaj jemi këtu.

Z.Kastriot Çobo – Faleminderit për punonjësit që erdhën për varrezat.

Kryetari i fshatit Cerkovinë – Problem rruga e varrezave.

Z.Ermal Dredha – Është në proces tenderimi dhe punimet fillojnë mbas fituesit.

Kryetari i fshatit Cerkovinë – Problem dhe uji i pijshëm, të bëhet dhe një depo tjetër.

Z.Ermal Dredha – Është përfshirë në projekt edhe Cerkovina, e tha drejtori i Ujësjellësit. Na thoni ndonjë gjë tjetër.

Kryetari i fshatit Cerkovinë – Problem me ndriçimin.

-Rrugët janë zënë, jo vetëm të brendshmet, por edhe ajo nacionale nga gardhet. Duam ndihmën e Policisë Bashkiake.

-Pastrimi i kanaleve, mbetet problem.

Z.Ermal Dredha – Bëmë një ndërhyrje në fshatin Aliban .

Kryetari i fshatit Cerkovinë – Për përroin....

Z.Adrian Vreshtazi – Është gati projekti nga Drejtoria e Urbanistikës dhe me fondet e Emergjencave Civile. Do ta bëjmë.

Kryetari i fshatit Bishan – Kemi 40% të fshatit, e ka ndërprerë autostrada. Të vijë policia, është thjesht nënvleftësim, nuk do investim.

Z.Kanan Shakaj – Faleminderit për mbështetjen Tuaj, zoti Kryetar. Të fillojmë me sallën, na duhen stola, është qendër për çdo aktivitet. Problem, ndërrimi i skrepit.

Z.Ermal Dredha – Z. Dorian , pse ka ngelur procedura e skrepit pezull?

Z.Dorian Demiri – Ngeli procedura, nuk u paraqit subjekti.

Z.Kanan Shakaj – Është viti i tretë që s'po e marrim dot skrepin.

Z.Ermal Dredha – Është procedurë dhe nga ana e ministrisë.

Z.Kanan Shakaj – Rrugët në dy fshatrat Delisuf dhe Dëllënjë, projekti është gati, por këto nuk janë përfshirë, si dhe rruga në fshatin Trevllazër dhe, duhet bërë projekti gati. Për dy fshatrat e tjerë, procedura është gati. Të parashikohen për vitin 2025.

Z.Ermal Dredha – Është mandat 4-vjeçar, pra vëmendjen do ta kemi maksimale në lidhje me problematikat dhe zgjidhjen e tyre.

Banor (Novoselë) – Familja ime mbytet nga uji, është bllokuar kanali.

Z.Kanan Shakaj – Lagjja e tyre ishte nga të parat ku u investua.

Z.Ermal Dredha – Zoti Azem, ne kemi fond në bashki për shtresat e komunitetit rom dhe egjiptian . Ti ndishmosh për aplikimet.

Kryetari i fshatit Fitore – Kemi një pompë ..., ndriçimi.

Z.Kanan Shakaj – Është gati, do të bëhet prova. Vetëm pritet të bëhet prova.

Z.Ermal Dredha – Problem ishte ndriçimi dhe në Lungomare, kishte mangësi në ndriçim. Ne do shohim tek projektbuxheti i vitit që vjen, kështu që, ne do ta bëjmë si korrigjim që të ketë me sasi në tenderim.

Çfarë keni ndonjë propozim apo kërkesë, të na i sillni në bashki

Faleminderit!

Koordinatorë për njoftimin dhe konsultimin publik

Albana Naçi